



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:049662

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05493067

P.nr.75/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të akuzuarit V. K, nga fshati Z. K e K, Rr. “N”, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.302/21, të dt.11.03.2021, për shkak të veprës penale “Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore” nga neni 318 par 3 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në prezencë të prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit V. K mbrojtësi të tij av. Gzim Kollqaku, përfaqësueses së të dëmtuarës Blerta Gagica, dëshmitarëve V. P, F. Zh, me datë 23.02.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.03.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V. K, i lindur me datë ....., në fshati Z. K. e K, ku edhe banon, nga i ati S., e ëma S, e vajzërisë H, ka të kryer fakultetin e Kriminalistikes, me profesion automekanik, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal ....., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë ....., rreh orës ....., në subjektin ekonomik N.T.SH. “K” (numër fiskal .....) e cila gjendet në fshatin Z. K. e K, pronar i së cilës në atë kohë ishte vetë i pandehuri me qëllim që vetës t’i mundësoj shmangien nga pagesa e detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera që paguhen me rastin e importimit të mallrave, nuk i paraqet D, mallin (pjesët-karroceritë e 56 automjeteve), vlera e të cilit mall tejkalon shumë prej 30.000 €, në mënyrë që, gjersa i pandehuri paraprakisht furnizohet me mallin vlera e të cilit (e llogaritur në automjete) është 26.614.94 €, ku detyrimi

doganor është 2,661.49 €, akciza 88,100.00 € dhe TVSH 21,127.74 €, të njëjtin mall nuk e paraqet pranë D, ku me datën kritike gjatë një aksioni policor në subjektin ekonomik “N.T.SH. K”, zyrtarët policor hasin në pjesët e automjeteve në fjalë, të cilët i evidentojnë të dhënat mbi to dhe nga hetimet doganore të zhvilluara rezulton se për mallin në fjalë i pandehuri i është shmangur detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera në shumën e përgjithshme prej 111,889.23 €.

Me çka ka kryer veprë penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, nga neni 318 par 3 të KPRK-së (04/L-082).

Andaj Gjykata në bazë dhe neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 52, 53, 73 dhe 74 nenit 318 par 3 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-ës, të pandehurin e:

## GJYKON

### DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM ME GJOBË

I. Të pandehurin V. K, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej tri (3) vite, nuk kryen veprë të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen veprë penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

### DËNIM ME GJOBË

Të pandehurin V. K e denon me gjobë në shumën prej njëmijë e tetëqind (1800) €uro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj me këste në afat prej gjashtë (6) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Mundësia e pagesës me këste, do të revokohet nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë.

II. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuat, dënimi me gjobë do të shëndrrohet në dënim me burgim duke e llogaritur 20 (njëzet) €uro për një ditë.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të tarifës për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DËNIM PLOTËSUES: I shqiptohet Dënimi Plotësues konform nenit 62 par. 2, nën. Par 2.3 lidhur me nenin 66 të KPRK-së, Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

IV.Udëzohet: Pala e dëmtuar Përfaqësuesi i D të K, qe kërkesën pasurore juridike në vlerë prej 111,889.23€, ta realizoi në contest civil.

## A r s y e t i m

### *Historiku procedural*

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm, me datë 11.03.2021, ka ngrit aktakuzë me PP//II.nr.302/21, ndaj të akuzuarit V. K, nga fshati Z. K. e K, për shkak të veprës penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, nga neni 318 par 3 të KPRK-së (04/L-082).

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze ndaj të akuzuarit V. K, me datë ....., ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, nga neni 318 par 3 të KPRK-së.

Gjykata të pandehurin e ka udhëzuar me të drejtat e tij për ta kundërshtuar aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në akuzë.

I pandehuri përmes mbrojtësit të tij avokat Ardian Deskaj, ka paraqitur kundërshtim të provave dhe kërkesë për hudhje të aktakuzës, me pretendimin se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri në aktakuzën PP/II.nr.302/21 të datës, nuk ka prova se ka kryer këtë vepër penale i pandehuri V. K. Provat mbi të cilat bazohet aktakuza janë të papranueshme dhe të pambshtetshme.

Gjykata e shkallës së parë kërkesën për hudhje të aktakuzës të cilën e ka paraqitur i pandehuri përmes mbrojtësit të tij, a ka përcjell Prokurorisë Themelore në Pejë, për të dhënë përgjigje me shkrim, por i njëjti nuk është përgjigjur.

Gjykata me aktvendimin P.nr.75/2021 të datës 10.05.2023, pas vlerësimit të kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhjen e aktakuzës dhe shkresave të lëndës, të njëjtën e ka refuzuar si të pa bazuar me arsyetimin se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe pretendimet e palëve ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale që i bie në barrë, kurse kërkesa për hudhje të aktakuzës të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit është e pa bazuar, ndërkaq gjendja e plotë dhe e drejtë faktike përfundimisht do të shqyrtohet, analizohet, vlerësohet dhe vendoset në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Duke vepruar sipas kësaj aktakuze Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimet gjyqësor me datë 13.11.2023, 29.11.2023, 24.01.2024 dhe 21.02.2024.

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse, gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë seancave të këtij shqyrtimit gjyqësor pas procedimit të provave materiale dhe personale është vërtetuar gjendja faktike si në akuzë ashtu që i pandehuri V. K, me qëllim të shmangies nga tarifat doganore me subjektin ekonomik NTSH K, që gjendet në fshatin Z K e K, i janë hasur automjete të pa doganuara dhe me këtë veprim i njëjti duke iu shmangur detyrimeve për pagesat e tarifave doganore ka shkaktuar dëme doganës së Kosovës, në vlerë prej 111,899.23 euro. Tutje ka shtuar se nga dëgjimi në cilësi të dëshmitares V.P- zyrtare e Doganës së Kosovës, me dëshminë e saj edhe njëherë ka vërtetuar se fillimisht janë dyshuar 74 automjete të pa doganuara, prej të cilave pas verifikimit janë tërhequr 18 automjete meqenëse është konstatuar se këto automjete kanë qenë të personave të tjerë fizik e që kjo gjendje është vërtetuar sipas raportit të brendshëm të policisë. Sipas raportit nga sektori i kontrollimit post import, shmangia për këto 54 vetura është në shumën prej 111,899.23 euro, po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit F. Zh, vërtetohet fakti se i njëjti gjatë vitit 2017, pasi kishte pësuar aksident ia kishte shitur të pandehurit rreth 150 automjete por që pjesa dërmuese e këtyre automjete është blerë nga personat e ndryshëm dhe një verifikim paraprak, edhe i pandehuri në mbrojtjen dhënë ka deklaruar se automjetet që janë hasur gjatë kontrolles nga policia në pllacin e tij janë blerë nga dëshmitari F. Zh, i cili po ashtu nuk kishte mohuar faktet se gjatë kontrolles së shitblerjes apo dakordimit verbal i njëjti i kishte deklaruar se për disa automjete dokumentacioni gjendet në doganë por i pandehuri nuk ka marr asnjë veprim për verifikim e prejardhjes së automjeteve dhe këtë sipas tij e kishte bërë sepse nuk kishte njohuri. Në fund prokurori në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe me provat e materiale që i janë bashkangjitur aktakuzës pasi që të administrohen nga gjykata do të vërtetojnë fajësinë e të pandehurit për veprën penale Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, nga neni 318 par 3 të KPRK-së, për çka është i akuzuar, andaj i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e caktimit dhe llojit të dënimit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit ti caktohet lloji dhe lartësia e dënimit i cili do të jetë në propocion me peshën e veprës penale përgjegjësin e tij penale dhe i cili dënim do të ndikoj të mos përsërisë vepra të tilla penale, në rastin konkret si rrethana renduese propozoj që të merret shuma e dëmit që sillet rreth 111,899.23 euro.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës-D. e K, B. G, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrahin fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe paraqesin kërkesën pasurore juridike ashtu siç është përcaktuar në kallëzimin penal dhe fakt se automjetet e demoluara kanë qenë të vulosura për shitje dhe i akuzuari nuk i ka deklaruar mallin pranë doganës, nënkupton disponim të

jashtëligjshëm të mallit dhe shmangie nga mbikëqyrja e mallrave të cilat i nënshtrohen pagesave të tarifave të detyrueshme doganore. Në fund ka shtuar se kërkojnë nga gjykata që në procedurë penale ta detyroj të akuzuarin që shumën prej 111,899.23 euro ta paguaj në emër të shmangies së detyrimeve doganore apo tarifave akcizave.

Mbrojtësi i të pandehurit V. K, avokat Gëzim Kollqaku, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij me aktakuzën e prokurorisë akuzohet se ka kryer veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, nga neni 318 par 1 lidhur me par 3 të KPRK-së, e nëse thirremi në par 1 të kësaj dispozite, kjo dispozitë parasheh që pagesa doganore apo tarifave të tjera apo detyrimeve doganore paguhet me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave që do të thotë që sipas dispozitave ligjore kjo veprë penale është specifike e cila kryhet me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave. Më pas mbrojtësi ka shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëshmia e dëshmitarit F. Zh, është vërtetuar se të gjitha automjetet prej 150 sosh i njëjti ia ka shitur të pandehurit në vlerë prej 200-300 euro për automjet ngase të gjitha automjetet kanë qenë të shkatërruara vetëm guacën e automjeteve e që sipas raportit të policisë dhe doganës së Kosovës shumica e këtyre automjeteve kanë qenë të vitit 1999 e deri në vitin 2005, që do të thotë automjetet kanë qenë të vjetra më shumë se 10 vite në kohën kur i pandehuri i ka blerë nga F.Zh, i njëjti gjithashtu ka pohuar se të gjitha këto automjete i ka blerë me dokumentacion valid dhe se gjatë viti 2016 ka pasur një kontroll nga policia dhe janë marr një pjesë e dokumentacioneve për këto automjete dhe siç thotë F, vetëm këto automjete ja kam hapur pa ato dokumentacione që kanë qenë në polici, pra i mbrojturi im ka qenë në lajthim faktik në momentin kur i ka blerë këto automjete duke menduar se të gjitha këto automjete e që më shumë se 70% sipas fotografive që disponojmë ato automjete kanë qenë më shumë guaca që i njëjti i ka ble me qëllim që ti shet për hekur me kille. Sipas të mbrojturit të tij dhe dëshmitarit ato automjete janë marr çdo herë pasi janë verifikuar se a janë paguar doganat apo jo kësisoj i ka thënë edhe të pandehurit dëshmitari dhe i njëjti i ka besuar duke ra në lajthim faktik andaj me përgjegjësi të madhe them se për të njëjtat automjete ndaj dëshmitarit F, janë udhëhequr hetimet këtë e di për shkak se këtë e di pasi është marrë me këtë çështje kur F ka qenë në hetime. Duke marr parasysh dispozitat ligjore thuhet se pagesa doganore ose shmangia doganore bëhet në rastin kur dogana nuk paguhet në rastin e importimit apo eksportimit të mallrave e që shumica këtyre automjeteve kanë hyrë 10-12 vite para se këto automjete të konfiskohen nga policia dhe dogana logjikisht tregon faktin se i mbrojturi im nuk ka mundur të ketë idenë se një automjet të cilin e ka marr F në vitin 2017, i cili ka qenë i viti 2009, ka qëndruar në Kosovë për 17-18 vite pa u doganuar, andaj duke i marr të gjitha këto rrethana deklaratën e vet dëshmitarit F. Zh, e konsiderojnë se në rastin me të keq

këtë vepre penale e ka kryer nga lajthimi faktik nga neni 25 të KPRK-së, kjo dispozitë thuhet që personi i cili kryen një vepër penale nga lajthimi faktik nuk është përgjegjës për këtë vepër penale, andaj nga kjo gjykatë kërkohet që konform nenit 363 par 1 nen par 1.3të bije aktgjykim lirues.

#### *Deklarata e të akuzuarit*

I akuzuari V. K, në mbrojtjen e tij të dhënë pranë gjykatës ka deklaruar se merret me servisimin e automjeteve dhe përveç servisimit ka edhe pllac ku vendosen automjetet jo funksionale. I pandehuri ka deklaruar se në vitin 2018 ka pas kontroll nga ana e policisë në pllacin për automjetet jo funksionale duke shtuar se nuk i kujtohet koha dhe data e saktë veç se e din që herët në mëngjes kanë ardhur policia të cilët kanë pasur urdhër për bastisje për armë dhe gjatë bastisjes kanë gjet një armë pastaj kanë vazhduar me bastisje në servise dhe në pllac të cilët menjëherë e kanë thirrur njësitin e auto krimeve për verifikimin e numrave të shasisë të automjeteve me dyshimin se mos ka ndonjë automjet të vjedhur duke shtuar se të njëjtin e kanë dërguar në mbajtje për 24 orë dhe pastaj kanë vazhduar edhe 2 ditë duke verifikuar automjetet që i ka pasur në pllac, ka përfunduar bastisja dhe më nuk ka qenë askush, përveç armës nuk kanë gjetur asgjë tjetër. Policia i kanë konfiskuar targat e kerreve dhe dokumentet që kanë gjetur, zyrtarët e doganave nuk kanë qenë ndonjëherë në plaç por të njëjtit e kanë ftuar në P. I pandehuri tutje ka deklaruar se të gjitha automjetet i ka ble në mënyrë grupore nga F Zh, në vitin 2018, disa i ka marr me dokumente kurse disa nuk kanë pasur dokumente për të cilat Fadili i kishte thënë se janë në doganë pasi që kishte pasur kontroll doganore. Automjetet kanë qenë komplet në gjendje jo të rregullt- të shkatërruar, përafërsisht kanë qenë dikund 80 automjete, ku Fadili kishte pasur një aksident dhe e ka mbyllur biznesin nuk ka mundur të punoj dhe ia ka ofruar me çmim të volitshëm rreth 50,000 mijë euro. Të gjitha automjetet e shënuara në procesverbal nga policia si fallc kanë qenë të Fadilit, duke shtuar se automjete i ka ble në nëntor të vitit 2017 kurse deri në qershor të vitit 2018, ato vetura kanë qenë do në P, e do në K dhe secili automjet në plaç në kohën kur ka qenë policia kanë qenë të blera nga F, sepse nuk ka pasur tjera dhe për secilin automjet të blerë F, i kishte thënë se janë të doganuara. Kontratë të shitblerjes me F, nuk kanë pasur por mënyra e blerjes ka qenë kompensim për ndërrim të veturës me veturë dhe vlerën me të holla, të gjitha automjetet e nxjerra nga pllaci kanë qenë të marrura nga F pavarësisht numrit sepse nuk i kujtohet saktësisht. Në fund i pandehuri ka deklaruar se nuk ka ndërmarr veprime për ti verifikuar prejardhjen e atyre automjeteve sepse nuk e ka ditur se si funksionin ajo punë, nuk ka mundësi me qenë 148 automjete pa obligime doganore të kryera sepse dogana i kishte verifikuar edhe njëherë sepse policia nuk ka mundur të jetë e saktë në atë kontrolle, numri i

automjeteve të dalura pa doganë nuk më kujtohet F, nuk kishte thënë se janë të paguar por që janë në doganë i kam besuar e kam pasur shokë dhe nuk e kam pyetur se ka i ka marrë ato automjete.

#### *Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor*

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës për të cilën është akuzuar, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlikur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 360 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi: Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë nga:

- Raporti njoftues nga V. P- Udhëheqëse e Njësitit të Sektorit i Hetimeve- DK, aneksi numër 1 për lëndën ..... dt....., nga D... e K...., Mendimi për përcaktimin e vlerës nga B. Ç-Udhëheqës i Sektorit të vlerës nga Dogana e Kosovës dt....., Raporti informativ nga sektori i kontrollit pas-importues me nr..... dt ....., Forma e shënimit të brendshëm dt...nr....., kopja e listës së kërkesës për verifikim nga Policia te Dogana, nr....., Pasqyra tabelore e të gjitha veturave si dhe shkresat e tjera të lëndës.

#### *Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor*

Dëshmitarja V. P, në deklaratën e saj të dhënë pranë gjykatës ka deklaruar se punon në Doganën e Kosovës në sektorin e përkrahjes së drejtorit të përgjithshëm dhe se natyra e punës së saj është raporti në emër të drejtorit të përgjithshëm, koordinimi i punëve brenda doganës. Dëshmitarja ka deklaruar se lidhur me këtë rast lëndën e kishte punuar me datën 25.01.2021 dhe me datë 27 janar e kishte njoftuar prokurorin me një raport njoftues nga e cila ka marr autorizimin verbal për të përpiluar një kallëzim penal vetëm për veturat që janë pronësi të subjektit K, fillimisht është dyshuar që janë 74 vetura, prej këtij numri 18 i kanë përjashtuar prej dosjes meqenëse ato janë konstatuar që janë të persona tjerë fizik, pjesën tjetër sipas raportit të policisë që janë 56 prej tyre në emër të subjektit K, i kanë dërguar për vlerësim dhe konstatim të shmangieve kur pas pranimi të raportit të sektorit të kontrollit post import, është konstatuar se shmangiet për këto 56 vetura janë lartësi prej 111,889.23 euro me dt. 02.02.2021, kallëzimi penal është percjellur në Prokurorinë e Pejës, në bazë të nenit 312 pika 5. Dëshmitarja ka deklaruar se detyrimi doganor dhe shmangia doganore krijohen në momentin kur gjendet se pala disponon me mallin dhe nuk ka deklaruar se ato mjete i ka pasur në pllac identifikimin e automjeteve e ka bërë polici.

Dëshmitarja në funde ka deklaruar se për doganë përgjegjës është pala që e ka ble mallin, përderisa pala nuk ka prezantuar asnjë dokument të shitblerjes së mallit. D e K nuk është obliguar të mbajë të dhëna për automjete të cilat hyn në Kosovë në procedurë të rregullt, mirëpo shitblerja e atyre automjeteve brenda shtetit si të pa deklaruara në doganë konstatohet veçer penale në momentin e disponimit të mallit nga pala.

Dëshmitari F. Zh, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2017, ka punuar me një pllac për pjesë të kerreve në P, në fshatin P, të cilat kerre në nëntor të vitit 2017 ia ka shitur V. K. Arsye e shitjes ka qenë sepse ka pasur një aksident të rëndë dhe nuk ka qenë në gjendje të punojë më. Dëshmitari ka deklaruar se të pandehurit ia ka shitur të gjitha kerret dikund 150 kerre saktësisht nuk mund ta dijë. Më pas ka shtuar se nuk i kujtohet nga kush i ka blerë kerre pasi i ka ble nga persona të ndryshëm dhe në vitin 2014 ka pasur një kontroll nga policia me doganë ku ia kanë marr dokumentet e atyre kerreve të cilat i kishte çmontuar për pjesë. Në fund dëshmitari ka deklaruar se të pandehurit ia ka shitur disa automjete pa dokumente por nuk i kujtohet se sa ka qenë numri i tyre të cilat nuk kanë pasur dokumente, të gjitha automjetet i ka shitur vetëm për pjesë sepse kanë qenë jashtë funksionit kanë qenë vetura të vjetra të cilat kanë kushtuar diku 200-300 euro. Dëshmitari ka deklaruar po ashtu se ato automjete i kishte blerë vetë me letërnjoftim dhe dokumente të veturave dhe të dokumentet ia ka dorëzuar policisë dhe doganës kur kanë qenë në kontroll dhe se për pjesët që nuk ka pasur dokumentacion –libreze i ka treguar V, që i kanë marr policia dhe dogana.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve dhe të njëjtat i ka vlerësuar si reale, objektive, e po ashtu deklarata e tyre gjejnë mbështetje të plotë edhe në provat materiale të lartpërmendura, si dhe në vet deklaratat e të pandehurit i cili në asnjë moment nuk e ka mohuar faktin se nga dëshmitari kishte blerë të gjitha automjetet të cilat ndodheshin në pllacin e tij në momentin e kontrolles së bërë nga ana e policisë, duke mohuar se e ka ditur se të njëjtat janë pa dokumente dhe detyrime doganore dhe tarifa të tjera që paguhen me rastin e importimit të mallrave.

Provat materiale Raporti njoftues nga V. P- Udhëheqëse e Njësitit të Sektorit i Hetimeve- DK, aneksi numër 1 për lëndën .... dt....., nga Dogana e Kosovës, Mendimi për përcaktimin e vlerës nga B. Ç,-Udhëheqës i Sektorit të vlerës nga Dogana e Kosovës dt....., Raporti informativ nga sektori i kontrollit pas-importues me nr..... dt ....., Forma e shënimit të brendshëm dt..... nr....., kopja e listës së kërkesës për verifikim nga Policia te Dogana, nr....., Pasqyra tabelore e të gjitha veturave si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata i ka vlerësuar si prova të cilat janë siguruar në



mënyrë ligjore, dhe gjejnë mbështetje tek njëra tjetra e gjithashtu kanë mbështetje edhe në dëshmitë e dëshmitarëve e si të tilla gjykata i ka vlerësuar si prova të besueshme.

Nga Raporti njoftues i V. P.- Udhëheqëse e Njësitit të Sektori i Hetimeve- D. e K, u vërtetua fakti se në emër të “K”, me pronar V. K, këtu i pandehuri, janë gjithsejtë 56 automjete për të cilat është bërë shmangia doganore ku vlera e gjithmbarshme e këtyre automjeteve është në lartësi prej 26,614.94 euro, kurse taksat tjera janë si vlera totale 26,614.94 euro, dogana 2,661.94 euro, akciza 88,100.00 euro, TVSH 21,127.74 euro e totali del të jetë 111,889.23 euro.

Me anë të aneksit numër 1....., të datës ....., është vërtetuar fakti se borxhi doganor për veturat e gjetura në pllacin e “K” me pronar V. K, është 28,119.23 euro, ku në mënyrë të qartë janë përshkruar të gjitha automjetet e gjetura, viti i prodhimit të tyre, kubazhi, nr. karrocerisë, baza doganore, taksa doganore, akciza dhe TVSH.

Nga kërkesa për verifikimin nga Stacioni Policor në Klinë, Njësi i Hetimeve nr.i ....i datës ....., u vërtetua fakti se Stacioni Policor në Klinë-Njësi i Hetimeve, me datën ....., ka kryer një urdhër kontroll në auto servis “K”, pronë e V S K, dhe gjatë kësaj kontrole kanë evidentuar të gjitha automjetet dhe numrat verifikues të tyre qoftë edhe ato të pa lëvizshme dhe atyre që ju mungonin pjesë të ndryshme pasi që servisi në fjalë merrej edhe me shitjen e pjesëve të automjeteve përveç servisimit të tyre dhe të gjitha automjetet kanë qenë pa dokumente andaj edhe të njëjtit kishin kërkuar nga dogana që të njëjtat të verifikohen nëse kanë kryer obligimet doganore.

Po ashtu automjetet e gjetura në pllacin e të pandehurit janë paraqitur në forma tabelare me përshkrim të qartë për secilin automjet, vitin e tij të prodhimit kubikazha, nr. karrocerisë, baza doganore, dogana, akciza dhe TVSH që nënkupton se baza doganore bie mbi të pandehurin si pronar i mallit.

#### *Vlerësimi i deklaratës së të pandehurit*

Me kujdes të veçantë gjykata e ka analizuar dhe vlerësuar deklaratën e të pandehurit të dhënë pranë gjykatës ku i njëjti nuk e ka mohuar faktin se automjetet-pjesët e karrocerisë, për të cilat tani akuzohet, i kishte blerë nga F.Zh, por i njëjti e ka mohuar ta ketë ditur faktin se të njëjtat kanë qenë pa dokumente dhe pa obligime doganore të kryera dhe se për të njëjtat nuk ka bërë verifikim të prejardhjes për shkak se i kishte besuar Fadilit pasi që e kishte shok, gjykata këto pretendime i ka vlerësuar si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë provë dhe është vetëm për ti ikur përgjegjësisë penale për veprën penale që i vihet në barrë pasi që vet i pandehuri e ka pranuar që Fadili nuk i kishte thënë se këto automjete janë të paguara por që janë në doganë që

do të thotë se i pandehuri veç se ka qenë i njoftuar me faktin se për të njëjtat nuk janë kryer obligimet doganore dhe se të njëjtit si blerës dhe pronar i mallit i bije barra e tarifave doganore.

*Vlerësimi i pretendimeve të dhëna në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të të akuzuarit, V. K, av. Gëzim Kollqaku.*

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit K, av.Gëzim Kollqaku, të paraqitur në fjalën përfundimtare i cili ndër të tjera ka theksuar se duke marr parasysh dispozitat ligjore thuhet se pagesa doganore ose shmangia doganore bëhet në rastin kur dogana nuk paguhet në rastin e importimit apo eksportimit të mallrave e që shumica këtyre automjeteve kanë hyrë 10-12 vite para se këto automjete të konfiskohen nga policia dhe dogana logjikisht tregon faktin se i mbrojturi tij nuk ka mundur të ketë idenë se një automjet të cilin e ka marr F, në vitin 2017, i cili ka qenë i viti 2009, ka qëndruar në Kosovë për 17-18 vite pa u doganuar, andaj duke i marr të gjitha këto rrethana deklaratën e vet dëshmitarit F. Zh, e konsiderojnë se në rastin me të keq këtë vepre penale e ka kryer nga lajthimi faktik nga neni 25 të KPRK-së, kjo dispozitë thuhet që personi i cili kryen një vepër penale nga lajthimi faktik nuk është përgjegjës për këtë vepër penale, andaj nga kjo gjykatë kërkojmë që konform nenit 363 par 1 nen par 1.3të bije aktgjykim lirues, gjykata këto pretendime si dhe pretendimet e tjera të përshkruara më lartë në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të të pandehurit i ka vlerësuar si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në provat materiale duke i konsideruar si qëllim për ta minimizuar përgjegjësinë penale të të mbrojturit të tij pasi që vetë i pandehuri në asnjërën deklaratë nuk e ka mohuar faktin se automjetet i kishte blerë nga F, e po ashtu vetë i pandehuri në mbrojtjen e tij e ka pranuar që F, nuk i kishte thënë që dogana për të njëjtat ishte e paguar por e kishte njoftuar se të njëjtat janë në doganë.

*Vlerësimi i veprimeve të të akuzuarit*

Gjykata vlerësoi se në veprimet e të pandehurit V. K, formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale “Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore”, nga neni 318 par 3 të KPRK-së, si në vendin, kohën dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi ku i pandehuri me dashje e duke e ditur se automjetet nuk i kanë të paguar detyrimet doganore dhe janë pa dokumente të njëjtat i ka blerë dhe me qëllim që vetës ti mundësoj shmangien e pagesave e detyrimeve doganore dhe tarifave tjera që paguhen me rastin e importimit të mallrave nuk i paraqet D, mallin –pjesët e karrocetit e 56 automjeteve ku për të njëjtat i është shmangur detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera në shumën e përgjithshme prej 111,889.23 euro. Se i pandehuri i ka ndërmarr veprimet për blerjen e këtyre automjeteve u

vërtetuar nga vet deklarata e të pandehurit, nga dëshmia e dëshmitarëve si dhe nga provat tjera materiale që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

*Vlerësimi i dënimit të shqiptuar*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese për të pandehurin V. K, mori sjelljen e tij të mirë pranë gjykatës, padënueshmërinë e tij më parë, ndërsa si rrethanë renduese gjykata ka vlerësuar, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale andaj gjykata bazuar në këto rrethana dhe po ashtu në bazë të dispozitës ligjore të akuzuarit i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindjen se edhe me këto dënime të shqiptuar është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, dhe se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale që do të ndikon në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër në kuptim të preventivës gjenerale e që do të ndikoj që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

*Kërkesa pasurore Juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.*

Konform nenit 460 par. 1 i KPPRK-së, e dëmtuara D e K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË**

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

P.nr.75/21 me datë 22.03.2024.

Gjyqtarja  
Sabrije Rraci

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate themelore.

Numri i lëndës: 2021:049662  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05493067